



Znj. Shpresa Rogu
PËRGJEGJËSE E SEKTORIT TË
BUXHETIT DHE FINANCËS

Profili

Diplomuar në vitin 1992 në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, në degën Financë, Master Shkencor. Në vitin 1998 është certifikuar si “Kontabël i Miratuar”. Formimi i saj akademik dhe profesional është shoqëruar me një përvojë të qëndrueshme në institucione financiare dhe organizma të rëndësishme në vend.

Në fillimet e karrierës së saj profesionale, znj. Rogu ka ushtruar funksionin e financieres pranë Telekom Berat, për të vijuar më pas në një rol drejtues në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes financiare të filialeve Telekom në Berat, Kuçovë dhe Skrapar.

Gjatë periudhës 1998–2018, znj. Rogu ka qenë pjesë e institucioneve të mikrofinancës, si Fondi Shqiptar i Zhvillimit, kredia urbane, ku përmes trajnimeve të organizuara nga FMN dhe Banka Botërore, ajo zhvilloi njohuritë në fushën e mikrokredisë, veçanërisht në analizën financiare të bizneseve. Ajo ka shërbyer si Menaxhere Rajonale e degëve në Berat, Lushnjë, Kuçovë dhe Skrapar, ku ka qenë përgjegjëse për administrimin e riskut, mbikëqyrjen e stafit, menaxhimin e portofolit të kredive aktive, si dhe të portofolit write-off. Në vitin 2008, ajo u transferua në drejtorinë qendrore të “Fondit Besa”, pranë Departamentit të Financës, ku u angazhua në përpunimin e raporteve dhe analizimin e të dhënave financiare, si dhe në përgatitjen dhe monitorimin e transaksioneve bankare, duke siguruar saktësi dhe përputhshmëri me standardet institucionale.

Në vitin 2023, ajo iu bashkua administratës publike, duke u emëruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, fillimisht si specialiste finance. Më pas, ajo u emërua përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës. Në këtë rol, ajo ka zgjeruar dhe thelluar më tej njohuritë mbi administratën publike, veçanërisht në fushat “Menaxhimi dhe Kontrolli Financiar” si dhe “Auditimi dhe Kontrolli i Brendshëm”.

Ajo ka njohuri në programe financiare si Oracle dhe njeh mirë gjuhën italiane dhe angleze.

shpresa.rogu@dpm.gov.al